



# **BILANCI AFATGJATË I ENERGJISË TERMIKE**

## **2017-2026**

PRISHTINË, DHJETOR 2016

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE .....</b>	<b>3</b>
<b>PERFORMANCA ENERGJETIKE NË SEZONAT E KALUARA .....</b>	<b>4</b>
Energjia termike e prodhuar, e furnizuar dhe humbjet në rrjet.....	4
<b>HUMBJET E UJIT.....</b>	<b>5</b>
<b>SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE .....</b>	<b>6</b>
Historiku .....	6
Përshkrimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike.....	6
Përshkrimi i rrjetit të shpërndarjes .....	7
Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike.....	8
<b>PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI TERMIKE .....</b>	<b>10</b>
Metodologjia .....	10
Detaje lidhur me parashikimin e kërkesës .....	10
Parashikimi i kërkesës për energji termike .....	12
Parashikimi i humbjeve në rrjet .....	13
Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike .....	16
<b>PËRMBLEDHJE E BILANCIT AFATGJATË TË ENERGJISË TERMIKE.....</b>	<b>18</b>

## HYRJE

Bilanci Afatgjatë i Energjisë Termike, është përpiluar në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (neni 8), ku specifikohet se Bilanci afatgjatë dhe ai vjetor zhvillohen nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Termike, dhe pas marrjes së mendimit nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), dorëzohen për miratim në Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE). Po ashtu përcaktohet se Bilanci afatgjatë përfshinë periudhën dhjetëvjeçare dhe se duhet azhurnuar çdo dy vjet. NP Termokos SH.A për hartimin e këtij Bilanci është bazuar në dispozitat përkatëse ku specifikohet përmbajtja e Bilanceve dhe gjithashtu është bazuar në Dokumentin Udhëzues për Hartimin e Bilanceve të Energjisë Termike, të ZRRE-së.

Ky dokument hartohet për herë të parë në këtë format dhe paraqet planifikimin e parë për një periudhë 10 vjeçare të kërkesës për energji termike dhe prodhimit të nevojshëm të parashikuar për të plotësuar këtë kërkesë. Gjithashtu janë bërë edhe parashikimet për humbjet në rrjetin e transportit dhe të shpërndarjes së energjisë termike.

Të dhënat e paraqitura në këtë Bilanc janë të bazuara në të dhënat historike të sezoneve të fundit, në projeksionet zhvillimore aktuale, dhe në dokumentet (strategjitë, studimet) relevante, dhe për këtë të dhënat e paraqitura mund të konsiderohen se kanë saktësi dhe besueshmëri relative.

## PERFORMANCA ENERGJETIKE NË SEZONET E KALUARA


### Energjia termike e prodhuar, e furnizuar dhe humbjet në rrjet

Në vijim janë paraqitur të dhënat respektive për tre sezonet e fundit. Në sezonin 2015/2016 prodhimi i energjisë termike ka qenë 198,686 MW<sub>TH</sub> apo 26% më i madh se sa në sezonin e kaluar 2014/2015 dhe për 2.8 herë më i madh se sa në sezonin 2013/2014. Ndërsa, furnizimi i konsumatorëve me energji termike në sezonin 2015/2016 ka qenë 165,087 MW<sub>TH</sub>, respektivisht 29% më i madh se sa në sezonin 2014/2015 dhe 2.9 herë më i madh krahasuar me sezonin 2013/2014. Humbjet në rrjet të energjisë termike në sezonin 2015/2016 kanë qenë 16.9%, përderisa në dy sezonet e kaluara kanë qenë 19% dhe 18.9%. Në vijim, në mënyrë tabelore dhe grafike janë paraqitur të përmbledhura të dhënat e gjenerimit dhe furnizimit me ngrohje, si dhe humbjet përkatëse.

**Tab. 1 Energjia termike e prodhuar, e furnizuar dhe humbjet në rrjetin e shpërndarjes**

Energjia Termike MW <sub>TH</sub>	Prodhimi	Furnizimi	Humbjet sasiore	Humbjet në përqindje
	MW <sub>TH</sub>	MW <sub>TH</sub>	MW <sub>TH</sub>	%
Tetor 2015	9,179.00	7,508.42	1,670.58	18.20
Nëntor 2015	30,405.00	24,932.10	5,472.90	18.00
Dhjetor 2015	40,627.00	33,314.12	7,312.88	18.00
Janar 2016	43,169.00	36,032.22	7,136.78	16.53
Shkurt 2016	33,832.00	28,224.05	5,607.95	16.58
Mars 2016	34,581.00	29,278.21	5,302.79	15.33
Prill 2016	6,893.00	5,798.33	1,094.67	15.88
<b>Total 2015/2016</b>	<b>198,686.00</b>	<b>165,087.45</b>	<b>33,598.55</b>	<b>16.91</b>

**Fig. 1 Diagrami i humbjeve të energjisë termike gjatë tre sezoneve ngrohëse 2013/2014; 2014/2015 dhe 2015/2016**



## Humbjet e ujit

Më poshtë janë paraqitur në mënyrë tabelore dhe grafike humbjet e ujit 2013/2014; 2014/2015 dhe 2015/2016.


**Tab. 2 Humbjet e ujit m<sup>3</sup> gjatë sezonit 2015/2016**

Humbjet e ujit m <sup>3</sup>	2015/2016	2014/2015	2013/2014
Tetor	12,30	815	9,792
Nëntor	13,30	12,16	11,45
Dhjetor	11,70	14,44	13,39
Janar	10,93	13,01	12,42
Shkurt	12,24	13,10	10,16
Mars	12,71	12,70	9,551
Prill	6,262	11,86	0
<b>Total</b>	<b>79,468</b>	<b>78,114</b>	<b>66,780</b>

Humbjet e ujit gjatë sezonit ngrohës 2015/2016 janë gjithsejtë 79,468 m<sup>3</sup> që paraqet 1,354 m<sup>3</sup> apo rreth 2% më të mëdha se sa në sezonin e kaluar 2014/2015. Ndërsa krahasuar me sezonin 2013/2014, humbjet e ujit në këtë sezon janë më të mëdha për 12,688 m<sup>3</sup> ose rreth 19%.

Siç mund të shihet nga të dhënat e lartë-paraqitura, humbjet e ujit me gjithë përmirësimet e theksuara që janë bërë në këtë sezon, prapë mbesin të mëdha. Megjithatë objektivi afatgjatë i NQ Termokos është që humbjet vëllimore të ujit prej 19 % të zbriten në 10%

**Fig 2. Paraqitja grafike e humbjeve të ujit për tre sezone ngrohëse.**



## SISTEMI I ENERGJISË TERMIKE

### Historiku

NP "Termokos" Sh.A. është furnizuesi i vetëm i ngrohjes qendrore në Prishtinë. Krahas ngrohjes qendrore, NP "Termokos" Sh.A. gjithashtu ofron edhe shërbime të mirëmbajtjes të sistemit të ngrohjes qendrore për konsumatorët e saj. Kërkesa për ngrohje qendrore të ofruar nga NP "Termokos" Sh.A. është jashtëzakonisht e lartë. Kjo për arsye se NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje kualitative, 24 orë gjatë gjithë sezonit ngrohës, me një çmim më të lirë se sa alternativat tjera të ngrohjes.

Tani, NP "Termokos" Sh.A. ofron ngrohje qendrore për 12,856 konsumator (prej të cilëve 11,986 janë konsumator amvisëri dhe 870 konsumator afarist e institucional), përderisa numri i konsumatorëve potencial që parashihet të kyçen në sistemin e ngrohjes qendrore të NQ Termokos është përafërsisht 4,150 konsumatorë të tjerë. Një përlllogaritje detale, e cili pritet të bëhet së shpejti, do të na japë të dhëna më të sakta për numrin potencial të konsumatorëve të rinj të cilët mund të kyçen në rrjetin e NP Termokos. NP "Termokos" Sh.A. mbulon kërkesën për ngrohje të konsumatorëve ekzistues duke përdorur vetëm pjesërisht kapacitetin ekzistues. Kjo dërgon drejt konkluzionit që NP "Termokos" Sh.A., mund të ofrojë ngrohje qendrore për afro 4,150 konsumatorë të rinj, të kategorive të ngjashme me konsumatorët ekzistues, gjegjësisht një bazë konsumatorësh me kombinatorikë të përafërt me profilin e konsumatorëve të amvisërisë dhe atyre afarist e institucional.

### Përshkrimi i kapaciteteve për prodhimin e energjisë termike

Njësi bazë gjeneruese e energjisë termike është TC Kosova B, përmes sistemit të kogjenerimit. Kapaciteti i instaluar është 140 MW<sub>TH</sub>, ndërsa kapaciteti operativ vlerësohet të jetë 137.48 MW<sub>TH</sub>. Për prodhimin e energjisë termike shfrytëzohet avulli i cili ekstrahohet nga shkalla e PM e të dy turbinave në këtë termocentral. Këmbimi i energjisë avull/ujë bëhet në stacionin për ekstraktim të energjisë (HES), përmes dy këmbyesve me kapacitet nga 70MW. Ky stacion është në afërsi të TC Kosova B, dhe në tërësi menaxhohet nga Termokosi.

**Tab. 3: Kapacitetet e prodhimit të energjisë termike nga kogjenerimi**

Njësia gjeneruese	Kapaciteti i instaluar	Kapaciteti operativ	Viti i prodh/instal.	Vendi
Sistemi i kogjenerimit – TC Kosova B	2x70=140MW <sub>TH</sub>	137.48 MW	2014	TC Kosova B

Termokosi disponon edhe me kapacitete të veta të prodhimit të energjisë termike, kaldajat me lëndën djegëse mazut, të cilat janë përdorë para funksionalizimit të sistemit të kogjenerimit. Këto njësi prodhuese janë funksionale dhe mund të përdoren në raste specifike (mbulimi i kërkesave të energjisë në pikun e ngarkesës, dhe në rast të ndërprerjes së furnizimit nga KEK ).

**Tab. 4: Kapacitetet e stabilimenteve të prodhimit në ngrohtore**

Njësia gjeneruese	Kapaciteti instal.	η (%)	Kapaciteti në dispoz.	Lënda djeg.	Kons l.d. Kg/MWh	Viti i prodh/inst	Vendi
Kaldaja me ujë të nxehtë	2x58 = 116MW <sub>TH</sub>	85	98.6 MW <sub>TH</sub>	Mazut	105	1978	Termokos
	2x7= 14MW <sub>TH</sub>	90	12.6 MW <sub>TH</sub>	Dizel	96	1983	Ngroh. e QKUK
	4 MW <sub>TH</sub>	90	3.6 MW <sub>TH</sub>	Mazut	96	2003	Termokos
Total Kapac.	134MW <sub>TH</sub>	-	114.8MW <sub>TH</sub>	-	-	-	-

### Përshkrimin i rrjetit të shpërndarjes


Rrjeti primar i shpërndarjes me gjatësi të tubacionit prej 75 km dhe kapacitet të ujit prej 3500 m<sup>3</sup>, është i instaluar kryesisht në vitet e 70-ta, në pjesën e urbanizuar të Prishtinës. Përkundër investimeve posaçërisht në vitin e fundit rreth 50% e rrjetit është me gypa të riinjë të paraizoluara kurse pjesa tjetër me gypa të amortizuar.

**Tab. 5: Karakteristikat kryesore të rrjetit primar të shpërndarjes**

Rrjeti i Shpërndarjes dhe Nënstacionet			
Ngrohtorja e Prishtinës	Numri i Nënstacioneve	Gjatësia e rrjetit (km)	Numri i matësve ne termonenstacione
	367 total ( 350 aktive dhe 17 pasive)	75.00	nga 350 nënstatione aktive në 267 janë të vendosur matësit dhe janë funksional, kurse në 83 nënstatione nuk ka matës.

Në figurën më poshtë është paraqitur skema e rrjetit të shpërndarjes

**Fig 3. Shtrirja e rrjetit**



### Vizioni për zhvillimin e sistemit të energjisë termike

Termokosi, planet afatgjata për prodhimin të energjisë termike i bazon në sistemin e kogjenerimit, si burim i sigurt, ekonomikisht i favorshëm dhe i përshtatshëm në kuptim të mbrojtjes së ambientit. Kapaciteti aktual prej 140MW ( 2x70 MW ) dhe aftësia bartëse e termopërquesit (Rrjetit të transportit të energjisë termike) TC Kosova B – Termokos prej 160 MW, janë faktorë limitues për ekstraktim më të madh energjisë.

Planet zhvillimore të Termokosi bazohen edhe në TC Kosova e Re, në të cilin është i paraparë instalimi i sistemit të kogjenerimit.



Në vitet e ardhshme priten investime të mëdha në rrjetin e ngrohjes për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit, që rezulton në rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore të Termokos. Detajet janë të paraqitura në tabelat e mëposhtme :

**Tab.6: Skenari 1. Projektioni i Mesëm**

PROJEKSIONI I MESËM				
VITI	IVESTIMET mil €	ZGJERIMI i sipërfaqes m2	Sipërfaqja aktuale e kyçur m2	Sipërfaqja totale e kyçur m2
2016	1-1.5	51,000	1,169,539	1,220,539
2017	5-5.5	175,000	1,220,539	1,395,539
2018	4.5-5	225,000	1,395,539	1,620,539
2019	2-2.5	100,000	1,620,539	1,720,539
2020	2-2.5	85,000	1,720,539	1,805,539
2021	2	75,000	1,805,539	1,880,539
2022	2	75,000	1,880,539	1,955,539
2023	2	75,000	1,955,539	2,030,539
2024	2	75,000	2,030,539	2,105,539
2025	2	75,000	2,105,539	2,180,539
<b>totali</b>	<b>27</b>	<b>1,011,000</b>	<b>1,169,539</b>	<b>2,180,539</b>

**Tab.7: Skenari 2. Projektioni i Lartë**

PROJEKSIONI I LARTË				
VITI	IVESTIMET mil €	ZGJERIMI i sipërfaqes m2	Sipërfaqja aktuale e kyçur m2	Sipërfaqja totale e kyçur m2
2016	1.5-2	51,000	1,169,539	1,220,539
2017	5.5-6	225,000	1,220,539	1,445,539
2018	5-5.5	250,000	1,445,539	1,695,539
2019	2.5-3	150,000	1,695,539	1,845,539
2020	2.5-3	125,000	1,845,539	1,970,539
2021	2.5	105,000	1,970,539	2,075,539
2022	2.5	85,000	2,075,539	2,160,539
2023	2.5	85,000	2,160,539	2,245,539
2024	2.5	85,000	2,245,539	2,330,539
2025	2.5	85,000	2,330,539	2,415,539
<b>totali</b>	<b>32</b>	<b>1,246,000</b>	<b>1,169,539</b>	<b>2,415,539</b>

Zgjerimi i rrjetit në vitet e ardhshme do të bëhet bazuar në donacionet që janë të zotuar dhe të dakorduara, donacionet e projektuara nga Donatorët :

- KFW, 10 mil janë të zotuar dhe të aprovuara,
- Komisioni Evropian (IPA 2015)- 8.3 mil janë të zotuar dhe të aprovuara,
- Komuna e Prishtinës dhe investimet me mjete vetanake 0.5 mil janë të zotuar dhe të aprovuara.
- Gjithashtu kemi edhe projeksione tjera por jo edhe zotime konkrete

## PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI TERMIKE

### Metodologjia

Metodologjia e përdorur për parashikimin e kërkesës për energji termike është bazuar në të dhënat historike të konsumit, dhe karakteristikat e sistemit të ngrohjes qendrore për të mundësuar zgjerimin e rrjetit, e rrjedhimisht të bazës së konsumatorëve, si dhe të kapaciteteve prodhuese të energjisë termike. Gjithashtu në parashikimin e kërkesës janë marrë për bazë projeksionet zhvillimore të NQ Termokos e po ashtu edhe planifikimet e rritjes ekonomike të gjithmbarshme në shkallë vendi.

Projeksionet zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NQ Termokos kryesisht përfshijnë planifikimet për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes e rrjedhimisht rritjen e bazës së konsumatorëve / sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes.

Gjithashtu ndikimi i rritjes së gjithmbarshme ekonomike vlerësohet përmes indikatorëve të zhvillimit ekonomik si BPV.

### Detaje lidhur me parashikimin e kërkesës

Parashikimi i kërkesës për energji termike mund të bazohet në kërkesën / konsumin në rritje në tri sezonet e fundit. Në sezonet e mëhershme (5 deri në 10 vjetët e fundit) furnizimi me ngrohje nga NQ Termokos nuk ka qenë në nivelin e duhur, prandaj edhe kërkesa për kyçje në sistemin e ngrohjes qendrore ka qenë e papërfillshme. Aktualisht është duke u përgatitur, i cili do të tregoj kahet e zhvillimit dhe zgjerimit të rrjetit të shpërndarjes, përkatësisht përfshirjen e konsumatorëve të rinj. Numri i konsumatorëve të rinj, përveç nga fizibiliteti i zgjerimit të rrjetit në pjesë të caktuara

të qyteti, determinohet edhe me kapacitetin energjetik në dispozicion nga sistemi i kogjenerimit, i cili aktualisht është 140MW.

Numri i konsumatorëve të riinjë dhe energjia e angazhuar për ta, është paraqitur në strategjinë e zhvillimit afatgjatë dhe zgjerimit të rrjetit shpërndarës të Termokosit në periudhën 2016-2025 (dy skenarë të zhvillimit). Për hartimin e këtij Bilanci është marrë projeksioni (skenari) i mesëm.

Parashikimi i kërkesës për energji termike

Tab. 8: Parashikimi i kërkesës për periudhën 2017-2026

Nr.	Emërtimi	Njës.	2017/2018	2018/2019	2019/2020	2020/2021	2021/2022	2022/23	2023/2024	2024/2025	2025/2026
1	Sasia e furnizuar / kërkesa	MWh	238,435	283,053	302,757	318,958	336,301	350,060	361,963	375,653	389,342
2	Rritja e furnizimit sipas viteve	%	16.95%	18.71%	6.96%	5.35%	5.44%	4.09%	3.40%	3.78%	3.64%




Fig 4. Paraqitja grafike e sasisë ngrohëse për periudhën 2017 – 2026

**Parashikimi i humbjeve në rrjet**


Humbjet në rrjet përfshijnë humbjet në rrjetin e transportit të energjisë termike (TC Kosova B – NQ Termokos) dhe në rrjetin e shpërndarjes së energjisë termike.

Aktualisht humbjet në rrjetit e transportit të energjisë termike janë në nivelin 1.7 %, duke qenë se rrjeti është i ri i komisionar në nëntor 2014. Për shkak se me kohë rrjeti do të vjetërsohet dhe dëmtimet mund të jenë më të shpeshta, parashihet një rritje e nivelit të humbjeve prej 3 respektivisht 5 pikë përqindje. Pra parashihet në periudhën 2020-2026 ky nivel humbjeve të arrij 2.5%. Nga tabela shihet rritje e dukshme e humbjeve sasiore (në MWh) që kryesisht është rrjedhojë e rritjes së prodhimit nga kogjenerimi.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur humbjet në transport në rrjetin e kogjenerimit sipas viteve për periudhën 2017 – 2026:

**Tab.9: Humbjet në rrjetin e transportit (kogjenerimit) të energjisë termike TC Kosova B – NQ Termokos**

Nr.	Emërtimi	Njësia	2017/2018	2018/2019	2019/2020	2020/2021	2021/2022	2022/23	2023/2024	2024/2025	2025/2026
1	Humbjet sasiore në transport ne rrjetin e kogjenerimit	MWh	4,767	5,563	5,916	7,314	7,626	7,938	10,312	10,702	11,092
2	% e humbjeve ne transport		1.7%	1.7%	1.7%	2.0%	2.0%	2.0%	2.5%	2.5%	2.5%



**Fig 5. Paraqitja grafike e humbjeve në transport në rrjetin e kogjenerimit për periudhën 2017 – 2026**


Humbjet aktuale në rrjetin e shpërndarjes janë vlerësuar të jenë 15%, që paraqet një humbje relativisht të lartë për shkak të humbjeve në transmetim të nxehtësisë (sidomos të gypat e pa izoluar) dhe për shkak të rrjedhjeve të ujit. Siç është përmendur më lartë, në vitet / sezonet vijuese parashihen disa projekte të rehabilitimit me ndikim në zvogëlimin e nivelit të humbjeve. Gjithashtu edhe projektet e zgjerimit të rrejtit do të ndikojnë në zvogëlimin e nivelit të përgjithshëm të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes. Siç vërehet nga tabela fillimisht parashihet zvogëlim i humbjeve për 1.5 %, i cili trend i rënies do zbres gjer në 10%.

## BILANCI AFATGJATË I ENERGJISË TERMIKE

Në tabelën më poshtë janë paraqitur humbjet në rrjetin e shpërndarjes dhe të tërësishme sipas viteve për periudhën 2017 – 2026:

**Tab. 10: Humbjet në rrjetin e shpërndarjes**

Nr.	Emërtimi	Njësia	2017/2018	2018/2019	2019/2020	2020/2021	2021/2022	2022/23	2023/2024	2024/2025	2025/2026
1	Humbjet në rrjetin e shpërndarjes	MWh	37,212	38,598	39,341	39,422	37,367	38,896	40,218	41,739	43,260
2	% e Humbjeve në shpërndarje		13.50%	12.00%	11.50%	11.00%	10.00%	10.00%	10.00%	10.00%	10.00%
3	Humbjet e tërësishme në rrjet	MWh	41,979	44,161	45,257	46,736	44,993	46,834	50,531	52,441	54,352
4	Humbjet e tërësishme në përqindje	%	15.2%	13.7%	13.2%	13%	12%	12%	12.5%	12.5%	12.5%



**Fig 6. Paraqitja grafike e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe humbjet e tërësishme për periudhën 2017 –2026**

**Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike**

Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin). Gjithashtu planifikimet për prodhimin e energjisë termike reflektojnë edhe humbjet në rrjet, si dhe eficiencyn e energjisë. Një rritje më e madhe e prodhimit është paraparë në sezonet 2017/2018 dhe 2018/2019 (14.92 % respektivisht 16.69%), ndërsa në sezonet vijuese parashihet një rritje më e vogël që sillet në rangun prej 6.36% - 3.64%.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur prodhimi bruto i ngrohjes, prodhimi neto i ngrohjes dhe rritja e prodhimit sipas viteve / sezoneve 2016/2017 – 2025/2026:

**Tab. 11: Prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike**

Nr	Emërtimi	Njësia	2017/2018	2018/2019	2019/2020	2020/2021	2021/2022	2022/23	2023/2024	2024/2025	2025/2026
1	Prodhimi bruto i ngrohjes	MWh	280,414	327,214	348,014	365,694	381,294	396,894	412,494	428,094	443,694
	Rritja e prodh. sipas viteve		14.92%	16.69%	6.36%	5.08%	4.27%	4.09%	3.93%	3.78%	3.64%
2	Prodhimi neto i ngrohjes	MWh	275,647	321,651	342,098	358,380	373,668	388,956	402,182	417,392	432,602



## BILANCI AFATGJATË I ENERGJISË TERMIKE



**Fig 7. Paraqitja grafike e Prodhimit Bruto dhe Neto të ngrohjes për periudhën 2017 –2026**

BILANCI AFATGJATË I ENERGJISË TERMIKE

PËRMBLEDHJE E BILANCIT AFATGJATË TË ENERGJISË TERMIKE PËR PERIUDHËN 2017-2026

Nr.	Emërtimi	Njës.	2017/2018	2018/2019	2019/2020	2020/2021	2021/2022	2022/23	2023/2024	2024/2025	2025/2026
1	<b>Prodhimi bruto i energjisë termike</b>	<b>MWh</b>	<b>280,414</b>	<b>327,214</b>	<b>348,014</b>	<b>365,694</b>	<b>381,294</b>	<b>396,894</b>	<b>412,494</b>	<b>428,094</b>	<b>443,694</b>
2	Rritja e prodh. sipas viteve	%	14.92%	16.69%	6.36%	5.08%	4.27%	4.09%	3.93%	3.78%	3.64%
3	<b>Prodhimi neto i energjisë termike</b>	<b>MWh</b>	<b>275,647</b>	<b>321,651</b>	<b>342,098</b>	<b>358,380</b>	<b>373,668</b>	<b>388,956</b>	<b>402,182</b>	<b>417,392</b>	<b>432,602</b>
4	Humbjet në transport (në rrjetin e kogjenerimit)	MWh	4,767	5,563	5,916	7,314	7,626	7,938	10,312	10,702	11,092
5	% e humbjeve në transport	%	1.70%	1.70%	1.70%	2.00%	2.00%	2.00%	2.50%	2.50%	2.50%
6	Humbjet në rrjetin e shpërndarjes	MWh	37,212	38,598	39,341	39,422	37,367	38,896	40,218	41,739	43,260
7	% e Humbjeve në shpërndarje	%	13.50%	12.00%	11.50%	11.00%	10.00%	10.00%	10.00%	10.00%	10.00%
8	<b>Humbjet e tërësishme në rrjet</b>	<b>MWh</b>	<b>41,979</b>	<b>44,161</b>	<b>45,257</b>	<b>46,736</b>	<b>44,993</b>	<b>46,834</b>	<b>50,531</b>	<b>52,441</b>	<b>54,352</b>
9	Humbjet e tërësishme në përqindje	%	15.20%	13.70%	13.20%	13.00%	12.00%	12.00%	12.50%	12.50%	12.50%
10	<b>Sasia e ngrohjes së furnizuar / kërkesa</b>	<b>MWh</b>	<b>238,435</b>	<b>283,053</b>	<b>302,757</b>	<b>318,958</b>	<b>336,301</b>	<b>350,060</b>	<b>361,963</b>	<b>375,653</b>	<b>389,342</b>
11	Rritja e furnizimit sipas viteve	%	16.95%	18.71%	6.96%	5.35%	5.44%	4.09%	3.40%	3.78%	3.64%
12	Sipërfaqja totale	m <sup>2</sup>	1,395,539	1,620,539	1,720,539	1,805,539	1,880,539	1,955,539	2,030,539	2,105,539	2,180,539
13	Rritja e sipërfaqes totale	%	14.25%	16.12%	6.17%	4.94%	4.15%	3.99%	3.84%	3.69%	3.56%
14	Numri i nënstacioneve		410	445	463	482	501	522	549	573	600
15	Kapaciteti i instaluar	MW	275.60	275.60	275.60	275.60	315.60	315.60	315.60	315.60	315.60
16	Gjatësia e rrjetit	km	82	100	105	108	111	113	116	118	122